

LIGJ
Nr. 10 469, datë 13.10.2011

PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JOJONIZUESE
(ndryshuar me ligjin nr. 27/2013, datë 14.2.2013; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është kontrolli i ekspozimeve të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimi i rrezatimeve jojonizuese, duke shfrytëzuar të mirat që vijnë nga përdorimi i tyre.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton masat që synojnë mbrojtjen e publikut dhe të punonjësve nga efektet dëmtuese në shëndet, si rezultat i ekspozimit të tyre ndaj rrezatimeve jojonizuese në intervalin e frekuencave 0-300 GHz.

Neni 3
Përkufizime
(shtuar pika 13 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Efektet dëmtuese shëndetësore” janë efektet biologjike, që kanë pasoja dëmtuese në gjendjen fizike, mendore ose të përgjithshme të njerëzve të ekspozuar, qofshin ato afatshkurtra ose afatgjata.

2. “Ekspozim ndaj rrezatimit jojonizues” është rrezatimi i një individi nga fushat elektrike, magnetike ose elektromagnetike.

3. “Ekspozim profesional” është ekspozimi ndaj rrezatimeve jojonizuese, që ndodhin gjatë punës me pajisjet e këtyre rrezatimeve.

4. “Ekspozim publik” është ekspozimi ndaj rrezatimeve jojonizuese që marrin individët ose publiku, përjashtuar ekspozimet profesionale e mjekësore.

5. “Kufizime bazë” janë kufizimet ndaj ekspozimeve të fushave elektrike, magnetike ose elektromagnetike, në bazë të efekteve shëndetësore të përcaktuara. Në varësi të frekuencës së fushave, madhësitë fizike, që përdoren për të përcaktuar këto kufizime, janë

densiteti i rrymës (J), shkalla e përthithjes së energjisë specifike (SAR) dhe densiteti i fuqisë (S).

6. “Kufi ekspozimi” është kufiri i sipërm, i vendosur për ekspozimin e njerëzve ndaj rrezatimeve jojonizuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga efektet e dëmshme biologjike.

7. “Mbikëqyrje” është monitorimi i ekspozimit të individëve ndaj rrezatimeve jojonizuese ose monitorimi i burimeve që lëshojnë rrezatim jojonizues.

8. “Miratim” është miratimi i lëshuar nga trupa rregullatore, mbi bazën e një aplikimi për veprimtari me pajisje rrezatuese jojonizuese.

9. “Pajisja me rrezatim jojonizues” është çdo produkt i fabrikuar që prodhon rrezatim jojonizues.

10. “Pajisje elektromagnetike mjekësore” është çdo pajisje ose instrument që përdor fushën elektromagnetike për diagnostikimin ose kurimin e pacientëve që janë nën kontroll mjekësor.

11. “Rrezatim jojonizues (Fushë elektromagnetike)” është entiteti fizik që mbart ose ruan energjinë në hapësirë dhe që ushtron forcë mbi ngarkesat elektrike. FEM-ja përfshin fushat magnetike, elektrike ose statike, me frekuenca në intervalin 0-300 GHz.

12. “Veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues” është veprimtaria e personit fizik ose juridik, i cili zotëron, transferon, importon, eksporton, merr, përdor, fabrikon ose instalon pajisje me rrezatim jojonizues.

13. Struktura përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi është struktura përgjegjëse për inspektimin e veprimtarive me rrezatim, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Detyrimet e subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues

1. Të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimeve jojonizuese, janë subjekt i këtij ligji.

2. Çdo person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, është i detyruar të pajiset me akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jojonizuese.

3. Personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të pajisur me akt miratimi, detyrohen të zbatojnë dispozitat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera në zbatim të tij.

4. Personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimeve jojonizuese, duhet të punësojnë persona të kualifikuar për punë me këto pajisje, të monitorojnë ekspozimet e tyre dhe të marrin masat e nevojshme për uljen e ekspozimit, kur ato janë mbi nivelet kufi.

5. Punonjësit, që nuk kanë kualifikimin e nevojshëm për punë me pajisjet që emetojnë rrezatim jojonizues, duhet të trajtohen si individë të publikut.

6. Instituti i Shëndetit Publik bën vlerësimin e shëndetit, të efekteve të rrezatimit jojonizues si për punonjësit e ekspozuar profesionalisht, edhe për publikun.

KREU II

ORGANIZIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES NGA RREZATIMET JOJONIZUESE

Neni 5

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet *(ndryshuar me ligjin nr. 27/2013, datë 14.2.2013)*

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet është autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, i cili është ngritur dhe funksionon sipas parashikimeve të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton masat e nevojshme për të siguruar në çdo rast që ekspozimet e çdo instalimi ose pajisjeje që emeton rrezatim jonizues të jenë në përputhje me normat e miratuara nga rregulloret përkatëse.

Neni 6

Detyrat e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet *(ndryshuar shkronja “b”, shtuar shkronja “g” me ligjin nr. 27/2013, datë 14.2.2013; shtuar fjalë në shkronjën “b”, zëvendësuar fjalë në shkronjën “g” me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)*

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, përveç detyrave të përcaktuara në fushën e rrezatimit jonizues, ka edhe këto detyra për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese:

a) harton rregulloret dhe miraton udhëzimet e aktet e praktikave të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë personat fizikë ose juridikë;

b) kontrollon zbatimin në praktikë të akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, në përputhje me ligjin për inspektimin, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi;

c) miraton veprimtaritë me burime të rrezatimit jonizues;

ç) bën rekomandime dhe propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese;

d) bashkëpunon me organizmat kombëtare e ndërkombëtare për problemet e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese;

dh) angazhon institucionet kërkimore-shkencore në të gjithë vendin për zgjidhjen e problemeve kombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese;

e) përcakton kërkesat për mbikëqyrjen e veprimtarive me rrezatim jonizues dhe monitoron ekspozimet e publikut dhe ekspozimet profesionale;

ë) kërkon nga çdo operator, prodhues, importues ose instalues i pajisjeve, që emetojnë rrezatim jonizues, të përmbushë respektimin e kufijve bazë dhe të kufijve të ekspozimit, nëpërmjet matjeve, deklaratave me shkrim ose certifikatave që lëshohen nga prodhuesit;

f) miraton procedurat testuese për pajisjet, që emetojnë rrezatim jonizues dhe ato elektromjekësore, si dhe për kompanitë që do të bëjnë testimin e tyre;

g) bashkëpunon me inspektoratin që mbulon fushën e punës dhe me strukturën përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi.

Neni 7

Organet që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji *(ndryshuar me ligjin nr. 27/2013, datë 14.2.2013; shtuar fjalë në fund të shkronjës “b”, shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)*

1. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është njësi ekzekutive e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, e cila, përveç detyrave të përcaktuara në fushën e rrezatimit jonizues, kryen edhe këto detyra:

a) Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;

b) Kontrollon në praktikë dhe mbikëqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese nëpërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi;

c) Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim jojonizues, në përputhje me ligjin për inspektimin;

ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet bazë e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;

d) Përgatit dosjet për miratimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues;

dh) Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij;

e) Mban inventarin për të gjitha matjet e kryera kombëtare të instalimeve dhe regjistrat e posaçëm për të gjitha matjet e kryera.

2. Shfuqizuar.

Neni 8

Informimi

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ose personat fizikë apo juridikë, të miratuar, që kanë marrëveshje me të, mund të publikojnë ose të shpërndajnë informacione, të dhëna për matje apo çdo material që ka lidhje me dispozitat e këtij ligji, në faqen zyrtare ose nëpërmjet broshurave të ndryshme.

KREU III

SANKSIONET

Neni 9

Sanksionet

(ndryshuar pikat 2, 3, 4 dhe 5 me ligjin nr. 27/2013, datë 14.2.2013; shtuar fjalë në paragrafin e parë të pikës 1 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen në përputhje me ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

a) shkelja e pikës 2 të nenit 4, për mospajisje me akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, dënohet me gjobë 500 000 lekë;

b) shkelja e pikës 5 të nenit 4, për punësimin e punonjësve të pakualifikuar, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

c) shkelja e pikës 3 të nenit 4, për moszbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve, të dala në zbatim të tij, dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 300 000 lekë.

2. Gjohet e vëna në zbatim të këtij ligji vendosen dhe shqyrtohen nga inspektorët e organeve që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji, sipas nenit 7 dhe në përputhje me ligjin për inspektimin si dhe janë dënime kryesore për qëllime të zbatimi të ligjit

për inspektimin.

3. Inspektori përkatës, sipas nevojave të rastit, vendos masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.

4. Ankimi ndaj dënimit me gjobë dhe masave urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

5. Ekzekutimi i dënimit me gjobë bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative, ndërsa ekzekutimi i masave urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

Nxjerrja e akteve nënligjore

Rregulloret për sigurinë e publikut dhe të punonjësve të ekspozuar ndaj rrezatimeve jopjonizuese miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Dispozitë kalimtare

(e ligjit nr. 27/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7141, datë 28.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi